

RREGULLORE ADMINISTRATIVE

NDËRMJET

DEPARTAMENTIT TË PUNËSIMIT DHE ZHVILLIMIT SOCIAL

DHE

MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË

PËR ZBATIMIN E

MARRËVESHJES PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

NDËRMJET KANADASË DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**DEPARTAMENTI I PUNËSIMIT DHE ZHVILLIMIT SOCIAL DHE MINISTRIA
E FINANCEVE DHE EKONOMISË (“autoritetet kompetente”),**

KANË RËNË DAKORT si më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përkufizime

- (a) Për qëllimet e kësaj Rregulloreje Administrative, **“Marrëveshje”** nënkupton *Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Kanadasë dhe Republikës së Shqipërisë*, në datën _____ në.
- (b) Çdo term tjetër përveç termit “autoritetet kompetente” i cili nuk është përcaktuar në këtë Rregullore Administrative dhe është përdorur në Marrëveshje, ka kuptimin që i është dhënë në Marrëveshje.

2. Agjencitë ndërlidhëse

Në zbatim të nenit 18 (2) të Marrëveshjes, organizmat e mëposhtëme do të veprojnë si agjenci respektive ndërlidhëse të autoriteteve kompetente:

- (a) për Kanadanë:

Divizioni i Veprimtarive Ndërkombëtare, Shërbimi Kanadez,
Departamenti i Punësimit dhe Zhvillimit Social, për të gjitha çështjet me përjashtim të zbatimit të neneve 6 deri 10 të Marrëveshjes, dhe paragrafit 3 të kësaj Rregulloreje Administrative; dhe

Drejtoria e Politikave Ligjore, Agjencia Kanadeze e të Ardhurave, në lidhje me zbatimin e neneve 6 deri 10 të Marrëveshjes, dhe paragrafit 3 të Rregulloreje Administrative; dhe

- (b) për Republikën e Shqipërisë (“Shqipëria”):

Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

3. Mbulimi i personave të punësuar dhe të vetëpunësuar.

- (a) Nëse depozitohet një kërkesë sipas Nenit 6(b) 6(c), 7 ose 10 të Marrëveshjes, agjencia ndërlidhëse, legjislacioni i të cilës zbatohet, do të lëshojë një certifikatë mbulimi që vërteton se çështja është subjekt i atij legjislacioni. Agjencia ndërlidhëse do të dërgojë një kopje të kësaj certifikate tek personi, i cili është subjekt i kërkesës dhe tek punëdhënësi i atij personi apo personit të vetëpunësuar, i cili është subjekt i kërkesës.
- (b)
 - (i) Nëse zbatohet legjislacioni shqiptar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të lëshojë një certifikatë mbulimi dhe do të dërgojë një kopje të certifikatës tek Drejtoria e Politikave Ligjore, Agjencia Kanadeze e të Ardhurave.
 - (ii) Nëse zbatohet legjislacioni kanadez, Drejtoria e Politikave Ligjore, Agjencia Kanadeze e të Ardhurave do të lëshojë një certifikatë mbulimi dhe do të dërgojë një kopje të certifikatës tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

PËRFITIMET

4. Përpunimi i një Kërkesë

- (a) Agjencia ndërlidhëse që merr një kërkesë për përfitim nga një person sipas legjislacionit të administruar nga agjencia tjetër ndërlidhëse, do ta dërgojë kërkesën pa vonesë tek agjencia tjetër ndërlidhëse dhe do të konfirmojë datën e pranimit të kërkesës.
- (b) Agjencia ndërlidhëse do të dërgojë bashkë me kërkesën çdo informacion që disponon që mund të jetë i nevojshëm për agjencinë tjetër ndërlidhëse për të përcaktuar të drejtën e personit për përfitim.
- (c) Agjencia ndërlidhëse do të vërtetojë informacionin për personin si pjesë e kërkesës dhe të konfirmojë se ky informacion është i vërtetuar nga provat shkresore. Agjencia ndërlidhëse nuk do të jetë e detyruar të dërgojë provat shkresore vërtetuese, nëse informacioni është i vërtetuar. Agjencitë ndërlidhëse bashkërisht do të vendosin llojin e informacionit që duhet të vërtetohet dhe mënyrën e vërtetimit.

- (d) Agjencia ndërlidhëse, deri në masën që e lejon ligji, i ofron agjencisë tjetër ndërlidhëse çdo informacion mjekësor të mundshëm në lidhje me paaftësinë e një personi.
- (e) Agjencia ndërlidhëse do t'i dërgojë agjencisë tjetër ndërlidhëse një formular ndërlidhës që përcakton periudhat e vlefshme dhe çdo informacionin tjetër sipas legjislacionit të saj që mund të jetë i nevojshëm për agjencinë tjetër ndërlidhëse për të përcaktuar të drejtën e personit për përfitim.
- (f) Agjencia tjetër ndërlidhëse vendos për të drejtën e personit dhe e njofton atë dhe agjencinë e parë ndërlidhëse në lidhje me vendimin për të dhënë apo refuzuar përfitimin.

TË NDRYSHME

5. Shkëmbimi i statistikave

Institucionet kompetente do të shkëmbejnë çdo vit statistika në lidhje me pagesat respektive sipas Marrëveshjes. Këto statistika do të përfshijnë të dhëna mbi numrin e përfituesve dhe shumën totale të përfitimit të paguar, sipas llojit të përfitimit.

6. Formularët dhe Procedurat e Detajuara

- (a) Agjencitë ndërlidhëse do të vendosin bashkërisht për formularët dhe procedurat e nevojshme për zbatimin e Marrëveshjes dhe të kësaj Rregulloreje Administrative.
- (b) Një agjenci ndërlidhëse mund të refuzojë të pranojë informacion ose t'i ofrojë informacion agjencisë tjetër ndërlidhëse, nëse agjencia tjetër ndërlidhëse nuk kërkon ose ofron informacion sipas formularit për të cilin agjencitë ndërlidhëse kanë vendosur bashkërisht.

7. Hyrja në Fuqi

- (a) Kjo Rregullore Administrative do të ketë efekt në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes dhe mbetet e vlefshme për periudhën kur Marrëveshja mbetet në fuqi.
- (b) Autoritetet kompetente, me miratim të ndërsjellë me shkrim, mund ta ndryshojnë këtë Rregullore Administrative.

NËNSHKRUAR në dy kopje në **OTAVA**, sot më **30 prill** 2019,
në gjuhën angleze, frënge dhe shqipe, ku secili version është njëloj i vlefshëm.


PËR DEPARTAMENTIN E
PUNËSIMIT DHE ZHVILLIMIT
SOCIAL TË KANADASË


PËR MINISTRINË
E FINANCAVE DHE EKONOMISË TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË